



Prishtinë, 12 mars 2014
Kodi i ZRRE-së: V_615_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Kërkesën e KOSTT për aprovimin e Rregullave të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve të CAO -EJL të datës 24 janar 2014,
- Kërkesën e ECRB (Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë – BRKE) për aprovim të dokumentit nga rregullatorët nacional.

në seancën e mbajtur me datë 12 mars 2014, nxori këtë:

V E N D I M

I Aprovohen Rregullat e Ankandit për Alokimin e kapaciteteve të CAO të EJL

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 24 janar 2014 ka pranuar kërkesën e KOSTT për aprovimin e Rregullave të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve të CAO të EJL. ZRRE ka qenë e kyçur gjatë periudhës së zhvillimit të dokumentit.

Këto Rregulla të Ankandit janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve të PTC CAO SEE (*Project Team Company Coordinated Auction Office in the South East Europe*).

Një çështje e diskutueshme ka qenë tabela në Aneksin 3 e cila si e tillë mbetet e paaprovuar. Ky aneks përmban TSO-të si palë Burim – Cak (Source - Sink Pairs), që ishte si çështje kontestuese në mes të palëve të rajonit të 8të. Tabela do të azhurnohet dhe aprovohet 2 muaj para fillimit të funksionimit të CAO.

ZRRE pas vlerësimit të dokumentit dhe kërkesës, konsideron se dokumenti plotëson kriteret e nevojshme për të qenë si rregull bazë për kryerjen e aktivitetit të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve dhe ka parë të arsyeshme që të **Aprovohen Rregullat e Ankandit për Alokimin e kapaciteteve të CAO të EJL.**

II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar